

MANJOLA ZAÇELLARI

IDENTIFIKIMI I UNIT POETIK ME IDIOMATIKEN E GJUHËS
POETIKE TE KRIJIMTARIA E A. Z. ÇAJUPIT

Abstrakt

Çajupi bën pjesë në grupin e shkrimtarëve me frazeologji të begatë. Këtë e dëshmon tërë krijimtaria e tij. Në punimin tonë ne jemi përqendruar pikërisht te raporti i tij me frazeologjitë, të cilat i kemi parë në dy sythe, së pari, në atë të poezive të tij dhe së dyti në komeditë e tij. Synimi ynë ka qenë që të tregojmë se në qasjen ndaj frazeologjisë nga Çajupi, nuk kemi raporte të asnjansit, gjuhës poetike, me frazeologjinë, por kemi identifikim të unit poetik me idiomatiken e traditës poetike, gjuhës poetike popullore. Uni poetik në këtë rast del si bartës i një tradite dhe individualiteti i tij përcaktohet pikërisht prej kësaj marrëdhënieje. Megjithatë, kur flasim për Çajupin flasim për një "individualitet". Parë nga ana stilistike ne kemi vërejtur se tek ai frazeologjia është e njëjtësuar me idiomatiken dhe nuk shihet si kundërvënie ndaj saj.

Fjalë kyçe: *frazeologji, gjuhë poetike, individualitet krijues*

Hyrje

Studiues që janë marrë drejtpërdrejt me Çajupin, sidomos ata që janë marrë me gjuhën e tij¹ kanë pohuar se megjithëse Çajupi u ka qëndruar më pranë të folmeve e folklorit të Labërisë, ka ditur t'u japë atyre ato vlera përdorimi sa të kapërcejë kufijtë e ngushtë të truallit gjuhësor².

Ashtu si dhe për autorë të tjerë, dhe për Çajupin, nënvizohet fryma popullore e gjuhës së tij. Sipas J. Thomait, në frazeologjinë e tij kemi tregues të dukshëm të burimit popullor: së pari, te fjalët që hyjnë si gjymtyrë të shprehjeve, që i takojnë jetës fshatarake; së dyti, te fjalët krahinore që tregojnë jo vetëm karakterin popullor, por dhe truallin gjuhësor ku janë formuar; së treti, kemi dukuri fonetiko-gramatikore dialektore, si arkaizma leksiko-gramatikore; së katërti, forma e njësive frazeologjike shpreh mënyrën e të menduarit popullor, psikologjinë, humorin, shijen dhe zgjuarsinë popullore³.

Ndërsa V. Memisha pohon se "Çajupi nuk u mbështet në gjuhën popullore, por se gjuha e tij është vetë shqipja, me të gjitha bukuritë,

¹ J. Thomai, *Tregues të karakterit popullor të frazeologjisë së A. Z. Çajupit*, Tiranë, 1992, f. 61.

² Shih për këtë T. Plangarica, *Veçori të organizimit të ligjërimit poetik të Çajupi*, Kërkime shkencore, Gjirokastër, 2002.

³ J. Thomai, *Tregues të karakterit popullor të frazeologjisë së A. Z. Çajupit*, Tiranë, 1992, f. 61.

mundësitë e aftësitë shprehëse të pakufi. Ai e mori brumin gjuhësor të vendlindjes, e përdori mjeshtërisht, e pasuroi me fjalë e shprehje, me lidhje të reja nga më mbresëlënëset, e pasuroi me nuanca kuptimore dhe e risemantizoi një pjesë të madhe të leksikut...⁴”.

Në këtë punim, për Çajupin raportet me frazeologjinë do t'i shohim në dy sythe, së pari, në atë të poezive të tij dhe së dyti në komeditë e tij.

Qasja në poezitë e A. Z. Çajupit

Dihet që burimet e poezisë sonë të Rilindjes janë te poezia popullore, aq sa, uni poetik identifikohet sakaq me poetin popullor⁵. Ky orientim ka ndodhur për dy shkaqe, të cilat së pari, janë romantike, folklorike, popullore etj., dhe së dyti, (ndryshe nga letërsitë e tjera evropiane), lidhen me mungesën e traditës së poezisë shqipe që vinte deri në atë kohë me traditën popullore, traditën e sermoneve fetare dhe me traditën e bejtexhinjve. Është kjo qasje që kushtëzon karakterin idiomatik/frazeologjik dhe të poezisë së Çajupit.

Po të shohim, asnjësi letrar, individualiteti poetik si un i një shkolle apo rryme drejtimi, vjen më vonë në poezinë shqipe. Është pikërisht kjo arsyeja, që tek Çajupi kemi identifikim të poetit a unit poetik me bardin popullor. Megjithatë, si tek disa autorë (N. Frashëri, Gj. Fishta, M. Kuteli, M. Camaj etj.) edhe këtu kemi të bëjmë me një individualitet.

Por Çajupi, që në qasjen e tij ndaj visarit popullor ndryshon, fjala vjen, nga Naim Frashëri⁶. Është interesante të vërejmë që te Naimi, megjithëse para Çajupit, e kemi asnjëanësin te uni poetik, çka, në fund të fundit e ngriti atë në nivelin e poetit kombëtar. Shkarazi këtu po themi që te Naimi, ndryshe nga Çajupi frazeologjia vijnë në kontrast me asnjëanësin e unit të tij poetik, që në atë rast merrte atributet e një gjuhe kombëtare.

Në rastin tonë, te Çajupi poezia vjen si idiomë poetike e Labërisë, me metrin, rimat, intonacionet e saj. Në këtë kontekst, në qasjen ndaj frazeologjisë nga Çajupi, nuk kemi raporte të asnjëanësit a gjuhës poetike me frazeologjinë, por kemi identifikim të unit poetik me idiomatiken e traditës poetike, gjuhës poetike popullore. Uni poetik në këtë rast del si bartës i një tradite dhe individualiteti i tij përcaktohet pikërisht prej kësaj marrëdhënieje. Megjithatë, siç e thamë, këtu kemi një individualitet krijues.

Tek Çajupi frazeologjia është e njëjtësuar me idiomatiken dhe nuk shihet si kundërvënie ndaj saj. Kjo është pasojë e identifikimit me bardin popullor, por ashtu siç e bëri këtë Çajupi.

Për këtë le të shohim një shembull:

Shqipëtar!

⁴ V. Memisha, *A. Z. Çajupi dhe pesha e fjalës së vendlindjes*, Tiranë, 2011, f. 220.

⁵ Shih për këtë U. Eco, *Për letërsinë*, Dituria, 2010; F. Dado, *Jeta dhe vepra e A. Z. Çajupit*, Tiranë, 1983.

⁶ Xh. Lloshi, *Fjala shqipe në poetikën e Naimit*, “Gjuha jonë”, Tiranë, 1991, nr. 2, f. 30-35.

*Shqipërin' e mori turku,
i vu zjarr!
Shqipëtar, mos rri, po duku,
shqipëtar!*

...
*Pesëqind vjet kemi rruar
me pahir,
Lidhure këmn' e duar
me zinxhir!...*

Në këto vargje, frazeologjia është e strukturuar jo si njësi semantike kundrejt një asnjëanësi, por si “gjuhë popullore poetike”, si vargëzim popullor, brenda të cilit është etnopsikika, mënyra e perceptimit të subjektit, etj. Por në boshtin paradigmatic kemi një zëvendësim: Çorrushin / Kurveleshin / Labërinë e kemi të zëvendësuar me Shqipërinë / shqipëtar. Dhe pikërisht në këtë zëvendësim del ideologjema e kombit, drejtpërdrejtë te Çajupi (ndryshe nga Naimi⁷: O malet e Shqipërisë / lisat...etj.)

Ndërkaq, e gjithë strofa është popullore. Frazeologjikja është te “*e mori turku/ i vu zjarr/ dhe së fundi te mos rri, po duku*. Dhe te strofa tjetër kemi po të njëjtën gjë. Por këtu kemi zgjerimin semantik, pra dekonstektualizimin e frazeologjive me: *Pesëqind vjet*, që sugjeron, si stilemë, ideologjemën e kombit, më sipër kishim *Shqipërinë*. Pra, në të dy strofat, dekonstektualizimi ka të bëjë me paradigmaticën, zëvendësimin e lokales (konteksti) me semantikën e kombëtares.

Të vijojmë më tej:
*O moj Shqiperiz' e dashur,
memëdhe,
Të shoh me buzë të plasur,
si më sheh.
Gjithë djemtë që ke qarë
dhe mban zi,
për Morenë janë vrarë,
për Turqi!*

Siç shihet, jemi gjithnjë te bardi popullor. *O moj / Shqipërizë e dashur / memëdhe / të shoh me buzë të plasur/ si më sheh*. Këtu frazeologjia nuk jeton si njësi më vete, në kundërvënie me unin poetik. Këtu kemi vetëm futjen e ideologjemës së kombit, gjithnjë në boshtin paradigmatic. Por, ajo që e dallon Çajupin nga poetët e tjerë të kohës së tij, është toni elegjiak (romantizmi). Ndoshta, prandaj dhe poezitë më të bukura të tij janë elegjitë. Por, gjithsesi te kthehemi te ideologjema e kombit. Dhe në këtë vargje ajo del direkt. Ndërkaq,

⁷ Shih me gjerë Xh. Lloshi, *Fjala shqipe në poetikën e Naimit*, “Gjuha jonë”, Tiranë, 1991, nr. 2, f. 30-35.

e thamë që frazeologjika/popullorja nuk del si tekst brenda tekstit, në kontrast me të, si te Naimi⁸, por është e njësuar me të.

Të shohim tani raportet me poezinë e bejtexhinjve, e cila, në fakt dhe ajo ka qenë jo pa ndikim në poezinë tonë popullore. Do ndalemi gjithnjë te synimi ynë, te frazeologjia.

Ja ç' kemi te **"Baba Tomorri"**:

*Të krishter' e myslimanë
gjithë një perëndi kanë;
ini nje gjak, mor të ngerë,
se ndë një vend kini lerë.
Ini gjithë shqipëtarë,
s'ini greker a tartarë,
hiqni dorë nga rreziku,
shihi se ç'punon armiku
i pabesi dhe i ligu.*

Dhe në këto vargje, ku ndihet tradita e bejtexhinjve, popullorja, frazeologjika nuk kundërqëndron ndaj një ansnjëansi që të veçohet si ngjyrim stilistik nëpërmjet tyre. Frazeologjika këtu është e shkrirë brenda tekstit, e njëjtësuar me të, është brenda botës së saj. Megjithatë, kemi dekontekstualizim, gjithnjë në boshtin paradigmatic: *të krishter e muslimanë*, pra del ideologjema e kombit / perëndia shqiptare / Baba Tomorri. Madje dhe titulli është bektashian dhe jo rastësisht, por që vërteton ideologjemën e kombit që ngrihet mbi lokalen a krahinoren. Dhe pikërisht kjo marrëdhënie përcakton individualitetin e Çajupit. Frazeologjia nuk del si tekst më vete brenda një teksti poetik, por është e shkrirë me të. Dhe, siç e pamë dhe më lart, individualiteti i Çajupit edhe këtu është te orientimi kundrejt repertorit frazeologjik, por jo vetëm të elegjiakes: *mor të mjerë / ini një gjak / ndë një vend kini lerë*. Vargu: *në një vend kini lerë / në sinonimi me: ini një gjak*, zbulon pikërisht etnopsikikën shqiptare (*qjaku / vendi / Shqipëria*).

Të shohim të njëjtën gjë te **"Trim i Shqipërisë"**:

*...Që ditënë, që na le,
vendi yn' u be raje')...
Të lutemi dit' e natë,
n'atë jetë ku ke vate,
dërgona shpresë e uratë
të mos rrojmë si gratë...
Të ngrihemi të lëftojmë,
Turqit t'i dëbojmë,
Shqipërinë ta shpëtojmë
Dhe lir' e me nder të rrojmë*

⁸ Xh. Lloshi, *Fjala shqipe në poetikën e Naimit*, "Gjuha jonë", Tiranë, 1991, nr. 2, f. 30-3.

Elegjiakja, popullorja shihet tek frazeologjitë: *që ditën që na le, u bë raje, dërgona shpresë e uratë, lir' e me nder të rrojmë*. Etnopsikikën popullore e kemi tek: *të lutemi ditë e natë, në atë jetë ku ke vatë* (vdekja në përfytyrimin popullor), *dërgona shpresë e uratë, të mos rrojmë si gratë*. Pra, siç shihet nuk kemi asnjëanës, por kemi elegjiaken popullore, që ngrihet te ideologjema kombëtare: *turqit t'i dëbojmë* etj.

Të shohim tani ç'ndodh me një poezi dashurie, te **“Dashuria”**
*...kurmi yt i derdhur, shtati yt i naltë;
gjithë më kënaqin, të tëra t'i dua,
po zëmëra jote u bë gur për mua!*

Siç shihet, njësia frazeologjike *u bë gur* është në mjedisin e vet etnopsikik, sepse kemi *kurmi yt i derdhur / shtati yt i naltë / zëmëra jote u bë gur për mua* – të cilat janë të gjitha popullore. Prej këndeje, është i qartë identifikimi i unit poetik me bardin popullor.

Qasja në komedinë **“Katërmëdhjetë vjeç dhëndërr”**

Komeditë e Çajupit janë komedi “zakonesh”. Natyrisht, te komeditë e tij frazeologjia mund të shihet në përvijimin e karaktereve. Por, edhe këtu jemi te frazeologjia që jeton në mjedisin e saj të idiomës / frazeologjisë popullore (dialektit). Pra, kemi të njëjtin qëndrim stilistik si te poezia. Por, nëse te poezia që është monologjike nga natyra e saj⁹, ndihet fakti që nuk kemi distancë nga gjuha e autorit dhe idiomatikja, çka siç e thamë e kishim te Naimi, te komeditë, fakti që frazeologjitë, dhe jo vetëm, por i gjithë repertori idiomatik vjen nga karakteret, e krijon distancën nga teksti i komedisë me gjuhën e spektatorit. Pra, në rastin e komedive të Çajupit asnjëanësi / normativizimi gjuhësor mbi dialektin është te spektatori, i kohëve të ndryshme, madje edhe i kohëve të sotme. Dhe është pikërisht kjo që kushtëzon suksesin e komedive të tij, ndryshe nga poezia e tij, që nuk e ka indin mbidialektor, siç e kishte, fjala vjen Naimi, te uni i tij poetik (dhe kjo, natyrisht, jo në të gjitha poezitë e Naimit).

U shprehëm se dhe te komeditë, frazeologjia jeton në habitatin e saj idiomatik.

Ja një shembull:
*Ç'jatro të të bie unë?
Mitrue s'është këtunë,
dhe Naum kokëshiniku
këtejë natën iku...
Në vende të tjerë vanë,
këtu vetëmë na lanë,*

⁹ Shih për këtë, M. Bakhtin, *Dostojevskij, poetica e stilistica*, casa editrice Einaudi, Torino, 2002; A. Graham, *Intertextuality*, Routledge, London and New York, 2000; M. P. Pozzato, *Semiotika e tekstit*, UET/Press, 2009.

*ikn' e muarë Misirë,
u hante koka për brirë...*

Në këtë strofë, frazeologjia e mirëfilltë është *u hante koka për brirë*. Por kjo njësi jeton në habitatin idiomatik të Labërisë: *Mitrua s'është këtunë / dhe Naum kokëshiniku / këtej natënë iku...* Në vende të tjera vanë / këtu vetëm na lanë / ikën e muarë Misirë. Në këtë rast pra, frazeologjia nuk është në kontrast me krejt strofën, nuk është ajo që ngjyros koloritin lokal, por e krejt strofa është kolorit lokal, ku natyrisht, kemi dhe etnopsikiken lokale, botëvështrimin prej saj (në këtë rast kurbetin) etj.

*Ja dhe në një shembull tjetër:
Të të vijë keq për mua:
punëtë janë të rënda,
S'punoj dot jashtë dhe brënda.
Puno sa të duash vetë
arat jepi me të tretë
Kjo punë s'bënetë kurrë,
po djali na u bë burrë.
Ndaj të lutem ta martojmë,
erdhi dita të gëzojmë.
Ne pa nuse pse të rrimë?
Kur të kem nusenë ndihmë,
punëtë bënenë vetë,
nukë rrojmë me jetë!
Pse s'më flet?*

Habitati idiomatik këtu shpërfaqet në të gjitha vargjet. Në strofën më poshtë kemi po të njëjtën gjë:

*I muarë mëntë gratë
Të bukur njeri që gjete!
Ai të kish mënt për vete,
nukë shkretonte shtëpinë,
s'kish marrë porropotinë!
Mëndjeprishur, zemërligu,
la të shoqenë dhe iku!
E zeza grua se ç'hoqi'.
Njëzet vjet e la i shoqi
dhe në pleqëri s'e poqi,
(Të mos arrij' të kish ardhë!).
nukë pa ditë të bardhë:
nat' e ditë duke qarë
nga turpetë që kish parë.
E mba mënt ç'grua ka qënë?
S'kishe shoqe në vënd tënë:*

*e nderçme, zëmërmirë,
punoj e rriti të birë.
Ka qenë grua për mbretinë.
burri s'ja diti kimenë.
Dhe tani në pleqëri,
dashuri më dashuri!
E gjetë nga perëndia,
se prishi shtëpin' e tia!
Gruaja vdiq nga qederi!
Këtë kërkonte dhe derri:
tani mban disa të tjera,
i vaftë shpirti në ferra!*

Dhe këtu, si te çdo strofë tjetër e Çajupit në komeditë e tij, frazeologjia jeton brenda tablosë idiomatike, të krahinore, lokale. Është pikërisht për këtë arsye që vargjet e tij janë, përveç të tjerash, dhe një “dokument” për psikologjinë krahinore, Labërinë, si një aspekt i psikolinguistikës (e cila do të kërkonte punime të tjera). Por, është e qartë, që në vargjet më sipër, si kudo te komeditë e tij, habitati idiomatik nuk është dominant, karakteristike e gjuhës së personazheve etj., kësisoj, por është vetëm ai: si p.sh. *i muarnë mendtë gratë/ të bukur njeri që gjete / ai të kish ment për vete* etj.

Ja një strofë tjetër, ku kemi një sfond të bukur psikolinguistik në portretizimin e gruas nga një grua:

*E bukur e punëtore.
Mos e pyet ç'grua është!
Si për ara dhe për vrështë,
pun' e saj s'gjëndet në jetë,
Punon vetëmci sa dhjetë!*

Dhe, në këtë rast kemi po të njëjtin habitat, ku frazeologjitë e mirëfillta janë pjesë e së njëjtës tabloje psikolinguistike: *e bukur e punëtore / mos pyet ç'grua është/ si për ara si për vrështë* etj...

Në përfundim mund të themi, që stilistikisht te Çajupi kemi të njëjtin poet, si te poezitë, si te komeditë. Por, nëse te poezitë ai nuk u ngrit në rangun e vargut naimian, (kombëtares), por mbeti te idiomatikja/frazeologjia, pikërisht ngase kemi njësim të tablosë gjuhësore me habitatin idiomatik, te komeditë ai krijoi të tjera përmasa, gjë që kushtëzoi mbijetesën e tyre, duke qenë se ato kishin destinacion spektatorin dhe janë të tipit të komedisë së zakoneve.

Ndërkohë, nëse te Naimi, frazeologjitë prodhojnë “dialog” me gjuhën e tij poetike, pra kontrastin me të, dhe prandaj ndihen si të tilla, te Çajupi kjo nuk ndodh. Kurse gjuha e komedive të tij është “dialog” dhe kontrasti në to vjen, p.sh. te “14 vjeç dhëndër”, prej kundërvënies burrë / grua (psiko-linguistikja),

siç e pamë dhe në shembujt më sipër, por siç dhe mund të konstatohet lehtësisht në të gjithë tekstin.

BIBLIOGRAFI

- A. Graham, *Intertextuality*, Routledge, London and New York, 2000.
F. Dado, *Jeta dhe vepra e A.Z.Çajupit*, Tiranë, 1983.
J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
J. Thomai, *Tregues të karakterit popullor të frazeologjisë së A. Z. Çajupit*, Tiranë, 1992.
M. Bakhtin, *Dostojevskij, poetica e stilistica*, Einaudi, Torino, 2002.
M. P. Pozzato, *Semiotika e tekstit*, UET/Press, 2009.
T. Plangarica, *Veçori të organizimit të ligjërit poetik të Çajupi*, Kërkime shkencore, Gjirokastër, 2002.
U. Eco, *Apocalittici e integrati*, Bompiani, Milano, 1993[1064].
U. Eco, *Për letërsinë*, Dituria, 2010
V. Memisha, *A. Z. Çajupi dhe pesha e fjalës së vendlindjes*, Tiranë, 2011.
V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011.
Xh. Lloshi, *Fjala shqipe në poetikën e Naimit*, “Gjuha jonë”, Tiranë, 1991, nr. 2.